



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr.121 dt.25.09.1998

**PER
DHENIEN E NDIHMES EKONOMIKE PER MUAJIN GUSHT 1998**

Në bazë të ligjit Nr.7710, dt.18.05.1998 “Për ndihmën dhe përkujdesjen shoqërore”, ndryshimeve të tij si dhe vendimeve dhe udhëzimeve në zbatim të tyre, Këshilli Bashkiak i Tiranës pasi shqyrtoi relacionin, projekt vendimin, borderotë dhe proces verbalin e mbajtur nga Komisioni Ekonomik dhe I Përkrahjes Sociale me dt.22.08.1998, për dhënien e ndihmës ekonomike për muajin gusht 1998

V E N D O S I

1. Të përfitojnë ndihmë ekonomike gjithsej **9576 familje** me një fond prej **36.485.692 lekë**. Për çdo njësi administrative si më poshtë :

Nj.A.	FAMILJE	FONDI	Nj.A.	FAMILJE	FONDI
1.	838	3.173.261	7.	692	2.650.488
2.	877	3.201.000	8.	666	2.491.572
3.	792	3.007.286	9.	794	3.019.232

4.	1.225	4.738.351	10.	560	1.990.452
5.	1.099	4.226.771	11.	953	3.875.186
6.	1.080	4.112.093			
			Shuma	9.576	36.485.692

2. Miratohet masa e ndihmës ekonomike për çdo familje sipas relacionit.
3. Të mos përfitojnë ndihmë ekonomike (të dalin nga skema) **238 familje** sipas pasqyrave përkatëse në relacion.
4. Të dalë nga skema e ndihmës ekonomike Adriatik Shira, familje me 2 antarë, Nj.A.11, për mostërheqje lekësh brenda afatit.
5. Të rihyjnë në skemën e ndihmës ekonomike **63 familje** sipas listës përkatëse në relacion.
6. Të trajtohet me ndihmë ekonomike të pjesëshme si rast i veçantë Robert Qafa, familje me 7 antarë, Nj.A.1, duke e afruar në nivelin maksimal të ndihmës ekonomike.
7. Të përfitojnë ndihmë ekonomike për paaftësi **1834 persona** me aftësi të kufizuar dhe **185 persona** për kujdesje ndaj një personi me aftësi të kufizuar gjithsej me një fond prej **8.333.070 lekë**.
8. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve të Jashtme , Drejtoria e Shërbimeve të Brendëshme dhe ekonomistët e njësive administrative.

KRYETARI

ORHAN SAKIQI